



KOMUNA
RAHOVEC

DRAFT- PROJEKT PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2022

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS.....	3
ZOTIMET.....	3
PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2022	4
SYNIME PËR VITIN 2022	5
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2022.....	6
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 2022.....	7
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË.....	11
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	13
DREJTORIA PËR ARSIM.....	14
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	16
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	18
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	19
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	21
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	22
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	25
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	26
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE	29
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	31
PËRFUNDIM	33

PARATHËNIE

Plani Vjetor i Punës, siç është paraqitur më poshtë, përkufizon synimin me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara, si dhe njëkohësisht liston të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve për secilën pikë. Personat përgjegjës obligohen që për çfarëdo shtyrje eventuale të afatit kohor të përfundimit të punëve, apo mospërmbytje ndaj të njëjtës, të raportojnë me shkrim te Kryetari i Komunës. Ndryshimet eventuale, për arsye kuptimplota, apo faktorëve të jashtëm, do të harmonizohen me Kryetarin e Komunës si dhe ekipin përgjegjës për realizimin e tërësishëm të këtij plani.

Pjesë përbërëse e planit të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2022 do të jenë planet e punës të të gjitha drejtorive komunale në komunën e Rahovecit si dhe njësitë të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- BUJQËSIA;
- EKONOMIA, AGROTURIZMI DHE PUNËSIMI;
- ADMINISTRATË BASHKËKOHORE ME SHËRBIME TË SHPEJTA DHE CILËSORE;
- ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE;
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE TË RREGULLUAR DHE TË MIRËMBAJTUR;
- INVESTIME NGA FONDI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT;
- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË SI DHE RRIJTJA E PËRKRAHJES PËR KËTA SEKTORË;
- PROMOVIMI I POTENCIALIT DHE MUNDËSIVE PËR INVESTIME NGA MËRGATA JONË;
- TRASHËGIMIA KULTURORE, HISTORIKE DHE INVESTIME PËR TA NDERUAR HARTËN E SAKRIFICËS DHE LIRISË.

ZOTIMET

- KOMUNË E HAPUR PËR QYTETARËT - TRANSPARENCË E PLOTË DHE LLOGARIDHËNIE;
- KOMUNË QË QEVERISËT DREJTË DHE MIRË, LIGJSHËM DHE ME PERFORMANCË TË LARTË;
- KOMUNË KU JU SHËRBEHET QYTETARËVE PA DALLIM;
- KOMUNË ME SHËRBIME GJITHNJË E MË BASHKËKOHORE;
- KOMUNË KU PROMOVOHEN POLITIKAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA SI DHE STANDARDET E LARTA TË QEVERISJES;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT NJERËZORE E QYTETARE;
- KOMUNË PA DISKRIMINIM E QË QYTETARËT I TRAJTON BARABARTË;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT KOMBËTARE, HISTORIKE, VLERAT E LUFTËS DHE TË LIRISË;
- KOMUNË QË NDERON SAKRIFICËN DHE GJAKUN E DERDHUR PËR LIRI;
- KOMUNË QË TRAJTON DHE MBËSHTET QYTETARËT QË KANË NEVOJA TË VEÇANTA;
- KOMUNË QË NDERON, PROMOVON E I JEP PËRKRAHJE TRADITËS, TRASHËGIMISË DHE GJITHË PASURISË SONË TË PËRBASHKËT, GJITHË ASAJ QË ËSHTË VLERË DHE IDENTITET I RAHOVECIT;
- KOMUNË KU PËRFAQËSOHET, MBROHET DHE PUNOHET PËR INTERESIN PUBLIK;

- KOMUNË KU PËRKUSHTIMI PËR TË VEPRUAR NDERSHËM DHE NË PAJTIM ME LIGJIN, PËRVEÇSE VULLNET, PËRCAKTIM I TË ZGJEDHURVE, JETËSOHET EDHE SI DETYRIM MORAL NDAJ ZGJEDHËSVE SI DHE NDAJ LIGJIT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHET MOZAIKU I VLERAVE NJERËZORE, DEMOKRATIKE, KULTURORE, TË TRASHËGIMISË E TË BESIMIT NË ZOT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN PAKICAT DHE PROMOVOHEN VLERAT E TYRE.

PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2022

- SHESHI QENDROR I QYTETIT;
- FUNKSIONALIZIMI I SHTËPISË PËR TË MOSHUAR;
- FUNKSIONALIZIM, MIRËMBAJTJE DHE MENAXHIM TE MAJA E SHKODRANIT;
- FUNKSIONALIZIM, MIRËMBAJTJE DHE MENAXHIM I KULLËS PËR HERONJTË XHELAL HAJDA-TONI, SELAJDIN MULLABAZI-MICI DHE BASHKËLUFTËTARËT E TYRE, HAMDI HAJRIZI, NEZIR IMERI DHE BEKTESH HALITI NË OPTERUSHË;
- EDUKIM DINJITIZ I BREZAVE TË RINJË, DUKE IU OFRUAR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE CILËSORE BASHKËKOHORE, MJEDIS TË PËRSHTATSHËM MËSIMOR ME INFRASTRUKTURË ADEKUATE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE;
- DO TË INVESTOHET NË FUNKSIONALIZIMIN E PLOTË TË ÇERDHEVE EKZISTUESE;
- BURSA PËR STUDENTË;
- BIBLIOTEKAT – DO TË KETË KUJDES TË SHTUAR PËR BIBLIOTEKAT, DUKE U PËRKUJDESUR PËR BLERJEN E TITUJVE TË RI, POR EDHE DUKE I MIRËMBAJTUR DHE INVESTUAR NË OBJEKTET E BIBLIOTEKAVE EKZISTUESE;
- LABORATORË DHE KABINETE – ME QËLLIM TË RRITJES SË KAPACITETEVE MËSIMNXËNËSE, KOMUNA DO TË INVESTOJË NË ZHVILLIMIN DHE KRIJIMIN E LABORATORËVE TË RINJ PËR SHKENCAT NATYRORE DHE KABINETEVE;
- PËRKRAHJE E FERMERËVE ME SERRA, STALLA, FERMA TË VOGLA, INPUTE DHE PAJISJE BUJQËSORE;
- RRUGË FUSHORE;
- PËRKRAHJE PËR PIKAT GRUMBULLUESE TË QUMËSHIT;
- KANALE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE;
- SHËRBBIME VETERINARE PERIODIKE, FALAS;
- KONSULENCË DHE HARTIM TË PROJEKTEVE FALAS PËR BUJQ DHE BIZNESE;
- NDËRTIM I RRUGËVE TË REJA DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE EKZISTUESE;
- NË BASHKËPUNIM ME KEDS, ANGAZHIM PËR FURNIZIM STABIL ME ENERGJI, NDËRRIM I RRJETIT, I SHTYLLAVE, INSTALIME NËNTOKËSORE ETJ;
- BASHKËPUNIM ME KRU “GJAKOVA” DHE DONATORË TË TJERË PËR FURNIZIM MË TË MIRË ME UJË TË PIJSHËM;
- EFICIENCA E ENERGJISË NË OBJEKTE PUBLIKE DHE NË SEKTORIN PRIVAT, PËRMES FONDIT TË MILENIUMIT;
- MIRËMBAJTJE E RREGULLT E HAPËSIRAVE PUBLIKE, E OBJEKTEVE PUBLIKE DHE TË GJITHA LLOJEVE TË INVESTIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E RAHOVECIT;
- LEGALIZIMI I PARKINGJEVE EKZISTUESE DHE KRIJIMI I PARKINGJEVE TË REJA;
- RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA;
- TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE RRUGËVE NË PJESË PROBLEMATIKE TË QYTETIT;
- MJEDISE TË BUKURA DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË;
- KËNDE LOJËRASH PËR FËMIJË;

- RITJE E STANDARDIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, PËRMES MENAXHIMIT TË MIRË DHE PROFESIONAL. NË BASHKËPUNIM ME NIVELIN QENDROR, DO TË INVESTOHET NË PAJISJE TË REJA E KAPACITETE NJERËZORE, PËR TA MUNDËSUAR RITJEN E KAPACITETEVE DHE CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA;
- TRADITA E INVESTIMIT NË SEKTORIN E KUTURËS, RINISË DHE SPORTIT DO TË VAZHDOJË PËRMES PËRKRAHJES SË TË RINJVE, SHOQATAVE KULTURORO-ARTISTIKE DHE KLUBEVE SPORTIVE;
- DO TË VAZHDOJË SUBVENCIONIMI I PROJEKTEVE KULTURORO-ARTISTIKE DHE SPORTIVE, QË JANË NË INTERES TË KOMUNITETIT;
- FILLIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2021-2025, E MIRATUAR EDHE NË KUVENDIN KOMUNAL TË RAHOVECIT;
- PËRKRAHJE DHE LEHTËSIRA PËR PRODHUESIT, TREGTINË, ZEJET E VEÇANTA, ARTIZANALET, ETJ;
- TRAJTIM DHE RREGULLIM I SHITËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE;
- PZHK DHE HZK - DO TË MIRATOHET PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTA ZONALE E KOMUNËS, PAS SHQYRTIMIT PUBLIK;
- RITJA E KAPACITETEVE INSPEKTUESE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT, DUKE I PARANDALUAR NDOTËSIT E SHKATËRRUESIT E AMBIENTIT, ME SHQIPTIM TË GJOBAVE MANDATORE;
- INVESTIM NË STACIONIN E AUTOBUSËVE NË RAHOVEC, FAZA E DYTË - INSTALIMI I KABINAVE INNOVATIVE NË STACIONET E PRITJES, NË QYTET DHE FSHATRA;
- ADMINISTRATË EFIKASE, E PËRGJEGJSHME DHE ME SHËRBIME MODERNE,
- QEVERISJE ENERGJIKE, VEPRUESE DHE VENDIMMARRJE PA VONESË,
- REALIZIM I SUKSESSHËM I PROJEKTEVE DHE I BUXHETIT,
- REALIZIM I PLANIT TË TË HYRAVE KOMUNALE,
- PROMOVIMI DHE PËRMIRËSIMI I MJEDISIT TË RAHOVECIT SI QYTET LIDER PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË BIZNESEVE EKZISTUESE, ZGJERIMIN E TYRE SI DHE PËR ATO TË REJAT;
- BASHKËPUNIM I MIRË ME DONATORËT E JASHTËM,
- KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME OJQ-TË.

SYNIME PËR VITIN 2022

- BUJQËSI TË PËRKRAHUR;
- RIPARIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE;
- INTERVENIMI NË NDËRTIMIN E KANALEVE TË KULLIMIT DHE DRENASHIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE;
- ZGJERIMI I SISTEMIT TË UJITJES NË PJESËT KU MUNGON;
- PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E PËRRENJVE;
- INVESTIME NË RITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, ZGJERIMIN E TYRE, ZGJATJEN E ORARIT TË SHËRBIMEVE, PAJISJE MJEKËSORE DHE INVENTARIZIM PËR QKMF DHE PËR GJITHË RRJETIN E SHËRBIMEVE PARËSORE SHËNDETËSORE;
- ARSIM CILËSOR DHE BIBLIOTEKA, PAJISJE BASHKËKOHORE, LABORATORË, MË SHUMË TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE MJETE KONKRETIZIMI NË SHKOLLA;
- HARTIMI I PLANEVE URBANE;
- ZHVILLIM EKONOMIK DHE PUNËSIM NËPËRMJET FUQIZIMIT DHE MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT;
- PËRQENDRIM PËR ZHVILLIMIN E PLANIFIKUAR TË AGROTURIZMIT;
- RITJEN E TË HYRAVE VETANAKE PËRMES LËSHIMIT TË LEJEVE NDËRTIMORE, PROCESIT TË LEGALIZIMIT DHE LEJEVE MJEDISORE KOMUNALE;

- NË BASHKËPUNIM ME DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE DHE RESPEKTIMIN E LIGJIT TË RI PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE;
- MBIKËQYRJE AKTIVE DHE RITJE E CILËSISË NË INVESTIMET PUBLIKE;
- VAZHDIMI I EVIDENTIMIT DHE LIRIMIT TË PRONAVE TË UZURPUARA NË NIVEL TË KOMUNËS;
- DYFISHIM I PËRPPJEKJEVE PËR MBROJTJE TË MJEDISIT, MBROJTJEN E TOKAVE BUJQËSORE, MBROJTJEN E PRONËS PUBLIKE, PARANDALIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE;
- PLANIFIKIMI I MASAVE PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË NË RAST TË FATKEQËSIVE NATYRORE DHE FATKEQËSIVE TË TJERA;
- PROJEKTE ME PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT;
- HARTIMI I PLANEVE, NXJERRJA E AKTEVE DHE RREGULLOREVE TË TJERA TË PUNËS;
- ZHVILLIMI I RAHOVECIT NË PËRPUTHJE ME PLANET ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FIZIKE BAZUAR MBI PARIMET E SHËNDOSHA MJEDISORE SI DHE MBI PARIMET E PARTNERITETIT ME MEKANIZMA VENDOR E NDËRKOMBËTAR, TË CILËT NDIHMOJNË NË ARRITJEN E VIZIONIT PËR KOMUNË MODEL ME NJË QEVERISJE KUALITATIVE, EFIKASE DHE LLOGARIDHËNËSE;
- VAZHDIMIN E TRAJTIMIT TË SHITRËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE, PËRMES INVESTIMEVE KAPITALE NGA KOMUNA E RAHOVECIT DHE MBËSHTETJES NGA QEVERIA E KOSOVËS, ME QËLLIM MBROJTJEN NGA VËRSHIMET DHE RUAJTJEN E MJEDISIT;

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2022

- BUXHETI I ULËT I QEVERISË SË KOSOVËS, MUNGESA E MJETEVE TË MJAFTUESHME FINANCIARE NGA QEVERIA QENDRORE SI TREND I VAZHDUESHËM NË KOSOVË, QË I BËN INVESTIMET EDHE MË TË VËSHTIRA (ANGAZHIME TË SHTUARA NË KËRKESA NGA QEVERIA QENDRORE);
- INTEGRIMI I SA MË SHUMË QYTETARËVE DHE THELLIMI I BASHKËPUNIMIT TË NGUSHTË ME ORGANIZATAT JOQEVERITARE (OJQ-TË), BIZNESET, ZANATLINJË, TREGTARËT, BUJQIT, SHOQËRINË CIVILE ETJ;
- MUNGESA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË GJITHË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT;
- MUNGESA E BURIMEVE TË MJAFTUESHME NJERËZORE DHE PROFESIONALE;
- PËRFSHIRJA MË E MADHE E QYTETARËVE TANË NË AKTIVITETET TONA DHE DUKE I MBAJTUR ATA TË INFORMUAR PËR TË GJITHA KËTO ZHVILLIME.

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 2022

Zyra Ligjore

Zyra Ligjore në komunën e Rahovecit me këtë plan synon arritjen e objektivave për vitin 2022:

- Ofrimin e këshillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e drejtorive, komiteteve të përhershme dhe konsultative, Zyrës së Prokurimit, komisioneve etj.)
- Harto (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale;
- Pjesëmarrjen në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara;
- Hartimin e rregulloreve sipas kërkesës së drejtorive;
- Pjesëmarrje të rregullt në seancat e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Njësia e Personelit në kuadër të kompetencave të saj, për periudhën deri në fund të vitit 2022, ka për synim të arrij këto objektiva:

- Mbajtjen e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit;
- Zbatimin e ndryshimeve të reja ligjore në fushën e resurseve njerëzore;
- Zbatimin dhe familjarizimin e punëtorëve dhe menaxhmentit me programin SIMBNJ;
- Mbikëqyrjen e pranisë së punëtorëve në punë;
- Përkujdesjen për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi;
- Menaxhimin efikas me arkivin e njesisë së personelit;
- Shkarkimi nga programi PYROLL i listës së pagave dhe pagesave në formë elektronike dhe dërgimi i tyre te zyrtarët përgjegjës;
- Krijimi i dosjeve pasive, sistemimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre.

Zyra e Prokurimit

- Plani i punës së Zyrës së Prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani synim i zyrës së prokurimit është që të kryejë të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

- Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore. Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë: përfaqësimi i komunës në seanca gjyqësore, ushtrimi i padive për palët, prapësimet e rasteve duke respektuar afatet ligjore, mendime juridike për zyrat e kryetarit dhe të drejtorive komunale, takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e komunës, ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore, mbajtja e regjistrave të lëndëve, pranim/dorëzim i shkresave dhe klasifikimi, pranimi i ftesave për seanca gjyqësore.

Nr.	Përshkrimi i objektivave të punës	Plani i veprimit	Bartësit e aktivitetit	Afati
1	Seancat gjyqësore	Mirëmbajtja e regjistrit elektronik të seancave të caktuara; Pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga gjykata; Përgatitja e lëndës për të marrë pjesë në seancë gjyqësore; Përgatitja paraprake e materialit për mbrojtje dhe përpunimi i provave materiale për dorëzim.	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
2	Përgatitja për seancat gjyqësore	Analizimi i lëndës, konsultimi i bazës ligjore; Sigurimi i të dhënave dhe dokumentacionit nga drejtoritë përkatëse; Përgatitja e materialit provues për mbrojtje; Përgatitja e mbrojtjes me shkrim.	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
3	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
4	Ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
5	Ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
6	Takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e Komunës	Konsultimet të rregullta mbi bazën e përgjegjësisë së deleguar; Takime informuese për lëndë dhe procedurën e caktuar;	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
7	Këshillimi	Përgatitja e këshillave ligjore, rekomandimeve, udhëzimeve dhe opinioneve brenda fushëveprimit të Komunës dhe me kërkesë të drejtorive apo organeve të Komunës	Avokati Komunal	Janar- Dhjetor
8	Mbajtja e regjistrave të lëndëve	Regjistrimi i lëndëve të reja; Bartja e evidencave dhe shënimeve për lëndë të caktuara; Çregjistrimi i lëndëve, etj.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor
9	Pranim/dorëzim i shkresave dhe klasifikimi	Pranimi i shkresave gjyqësore, etj.; Regjistrimi i shkresave; Vendorsja e shkresave në lëndë të referuara.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor
10	Pranimi i ftesave për	Pranimi dhe regjistrimi i ftesave për seanca; Përgatitja e lëndës për seancë;	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor

seanca gjyqësore				
11	Punë të daktilografimit	Përgatit parashtrës të ndryshme; Shkruan sipas diktimit të Avokatit; Përgatit shkresat bashkëngjitur provave.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor
12	Evidenca për punë lëndë në procedurë dhe të kryera	Mbajtja e evidencave të lëndëve në punë; Mbajtja e evidencave për lëndë të kryera.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor
13	Shënime dhe të dhënat statistikore	Mbajtja e shënimeve statistikore për të gjitha lëndë; Nxjerrja e të dhënave statistikore të përgjithshme për punën e zyrës së përfaqësimeve.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor
14	Parashtrimi i kërkesave për furnizim	Planifikimi i furnizimit të zyrës me material administrativ; Parashtrimi i kërkesave	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar- Dhjetor

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Plani i punës së Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun për vitin 2022, bazohet në Statutin e Komunës, Rregulloren Komunale për Transparencë 03/2019 dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale për vitet 2019-2023.

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë:

- Publikimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari, përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e kryetarit dhe drejtorive komunale, dërgimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari në MAPL, publikimi i raportit të qeverisë komunale për vitin 2021, publikimi i planit të punës së qeverisë komunale për vitin 2022, pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike, publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal-KPF-së dhe Komitetit për Komunitete, përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtime, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme, publikimi i dokumenteve-rezultateve të përgatitura nga OJQ-të për transparencë dhe llogaridhënie për komunën e Rahovecit, publikimi i konkurseve, publikimi i thirrjeve për aplikim, publikimi i ankandeve, publikime të tjera, sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës, fillimi i procedurave për përgatitjen e Strategjisë Komunale për Komunikim.
- Dokumentet si: Raporte, rregullore, plane të ndryshme, plane financiare, njoftime, lajme, ftesa ankande publike, thirrje dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga ana e kryetarit, ndikojnë direkt në rritjen e performancës, transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Rahovecit.
- Vendimet (publikimi i tyre është rregulluar edhe me ligj) e nënshkruara nga kryetari i komunës, dërgohen në MAPL dhe publikohen në uebfaqe zyrtare të komunës në vegëzën: https://kk.rks-gov.net/rahovec/staff/smajl-latifi/#vendimet_main, janë lehtë të qasshme nga ana e qytetarëve, mediat dhe OJQ-të por që nuk dërgohen për publikim tek mediat lokale dhe ato qendrore.
- Planet, rregulloret dhe dokumente tjera që duhet të kalojnë në debat publik, publikohen edhe në platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Gjatë vitit 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon të auditojë këto drejtori:

- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtoria për Arsim;
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;
- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Drejtoria për Shërbime Publike;
- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
- Drejtoria për Financa dhe Buxhet dhe
- Zyra e Prokurimit.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

- Zbatimi i Planit Lokal për personat e riadhesuar dhe kthim të qëndrueshëm 2019-2022;
- Takimet me Komisionin për Kthim të Komuniteteve;
- Monitorimi dhe realizimi i projekteve për të kthyerit;
- Bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete dhe Ministritë e tjera të linjës;
- Krijimi i data bazës mbi gjendjen në bujqësi, shëndetësi, arsim dhe gjendjes sociale të komuniteteve;
- Promovimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me fëmijët dhe barazinë gjinore të pjesëtarët e komuniteteve.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Në planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2022 përfshihen aktivitetet që do të realizohen në fushën e të drejtave të njeriut.

- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut (organizimi i fushatave sensibilizuese për të drejtat e njeriut, publikimi i doracakëve dhe broshurave informative, organizimi i tryezave, debateve të ndryshme për gjendjen aktuale të të drejtave të njeriut);
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve në proceset që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut (Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve për shkelje eventuale të të drejtave të njeriut nga institucionet komunale në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit);
- Përmirësimi i situatës së të drejtave të fëmijëve në komunën e Rahovecit (Lansimi i Strategjisë Nacionale për parandalimin e punës së rëndë të fëmijëve);
- Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë, krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë (në sektorin publik), në kontekst të zbatimit të të drejtave të njeriut;
- Integrimi i komuniteteve në të gjitha fushat e jetës dhe të punës në komunën e Rahovecit;
- Integrimi i personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra për Integritet Evropian do të kryej funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropian në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropian.

Bashkërendimi i aktiviteteve me Asociacionin e Komunave me ministritë e linjës (MAPL/ MIE), avancimi i sistemit të riintegritetit të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar, përmirësimi i bashkëpunimit dhe dialogut civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara, organizimi i këshillimit të përbashkët me ZKIE-të për finalizimin e planeve individuale nga obligimet e agjendës evropiane, raportet periodike (raporti vjetor janar-dhjetor 2022 për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane për komuna, raportimet 6 mujore për raportin e vendit, janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2022 në kuadër të ZIE-së.

Zyra për Barazi Gjinore

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Vetëdijësimi në çështjen e barazisë gjinore, mbajtja e ligjëratave, fushatave sensibilizuese në vise rurale dhe në qytet, zbatimi i rregullores për barazi gjinore, takime përgatitore me gratë e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioriteteve të grave me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjinore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të komunës, përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjinore, zbatimi, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre - janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2022 në kuadër të ZBGJ-së.

Në kuadër të këtij dokumenti të qeverisjes së Rahovecit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të drejtorive komunale.

Secila drejtori është përgjegjëse që në harmoni me objektivat strategjike të qeverisjes së komunës së Rahovecit të përcaktojë planin e vet të punës dhe ta realizojë të njëjtin, gjithëherë duke qenë në shërbim të qytetarëve.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Zbatimi i një qeverisje administrative duke u bazuar në rend të parë në legjislacionin në fuqi, lehtësimeve të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt qoftë sipas formave të sistemit elektronik, afirmimi i punës së hapur në administratë, trajtimit me kohë të kërkesave të qytetarëve, profesionalizmi, paraqesin shtylla bazike përmes së cilave qytetarët absorbojnë shërbime cilësore administrative në Komunë. Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribuues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë. Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Rahovecit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për vitin 2022.

Tremujori i parë i vitit 2022: janar, shkurt, mars

- Qysh në fillim vit do të kujdesemi që të pajisemi me numër të mjaftueshëm të certifikatave në mënyrë që të përballojmë fluksin e qytetarëve e në veçanti edhe të mërgimtarëve tanë të cilët pajisen me dokumente;
- Ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe disiplinës në punë, shtimin e efikasitetit në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/parashtresave të parashtruara nga ana e qytetarëve/bizneset si dhe subjektet e tjera;
- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, synohet ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda afateve ligjore;
- Mbikëqyrja e rrjetit, serverëve, kompjuterëve, pajisje të tjera të teknologjisë informative;
- Përgatitja dhe organizimi i seancave të rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat emergjente (gjatë tërë vitit);
- Përgatitja e materialit për mbledhjet e Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit (gjatë tërë vitit);
- Përgatitjen e procedruave për inventar dhe nevoja të tjera për administratën komunale,
- Të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të njëjtat do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Tremujori i dytë i vitit 2022: prill, maj, qershor

- Mirëmbajtja e serverëve;
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve (gjatë tërë vitit);
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Bordit të Drejtorëve dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi stimulant i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale (gjatë tërë vitit).

Tremujori i tretë i vitit 2022: korrik, gusht, shtator

- Muajt korrik dhe gusht do të shpallen si muajt e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore artistike, në Administratë do të rriten shërbimet për qytetarë dhe zyrtarët komunalë të Administratës do të punojnë me orar të zgjatur. Në kuadër të “Muajit të Mërgimtarëve”, do të hapet edhe një sportel i veçantë për mërgimtarë, gjithashtu do të kujdesemi për parking të veturave që të ketë vend të mjaftueshëm për mërgimtarët tanë;
- Në sektorin e arkivit do të bëhet pranimi dhe arkivimi i lëndëve të përfunduara nga ana e drejtorisë, të gjitha lëndët do të arkivohen në depo të komunës në pajtim me ligjin (gjatë tërë vitit);
- Organizimi i punëve të arkivit komunal përmes një protokollit hyrës, si dhe shpërndarja e lëndëve nëpër organet e komunës, drejtoritë e Administratës si dhe njësitë e tjera.

Tremujori i katërt i vitit 2022: tetor, nëntor, dhjetor

- Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë që të evidentohet çdo nevojë ose kërkesë e zyrave të vendit për shërbime sa më cilësore për qytetarët tanë;
- Kontrollimi i kablove dhe pajisjeve të rrjetit, pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve të mbledhjeve;
- Koordinimi me ASHI për licenca, instalimi i printerëve, instalimi i pajisjeve transmetuese;
- Servisimi i radiatorëve me rreze infra të kuqe;
- Mirëmbajtja e objekteve të komunës;

- Servisimi i automjeteve zyrtare;
- Sigurimi i automjeteve zyrtare.

Synime për vitin 2022:

Shërbimet komunale janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj Komuna e Rahovecit do të investojë në vazhdimësi në modernizimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Angazhim për digjitalizimin e administrates komunale.

Komuna e Rahovecit do të përkushtohet në rritjen e transparencës përmes aplikimit të metodave të reja të komunikimit online për qytetarë dhe medie.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në kuadër të përgjegjësi dhe kompetencave të përcaktuara me LVL, Statutin e Komunës, Ligjin për Shëndetësi si dhe Akte të tjera nënligjore, për vitin 2022 parasheh të zhvillojë aktivitete të cilat do të realizohen përmes angazhimit të kapaciteteve ekzistuese.

DSHPS këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në shëndetësi;
- Përkrahjes së mjekëve dhe personelit shëndetësor;
- Shërbimeve këshillimore për pacientë dhe
- Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e shëndetësisë.

Plani për shëndetësi ka tri qëllime kryesore:

- T'ju ofrojë qasje të shërbimeve shëndetësore të gjithë qytetarëve;
- Sistemi i përmirësimit të cilësisë, ju garantojmë që shërbimet e ofruara shëndetësore do të jenë të cilësisë së lartë, duke e ngritur kështu kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet e ofruara;
- Resurset humane, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore, të përmirësojë mirëqenien materiale dhe profesionale të punëtorëve shëndetësorë.

Tremujori i parë i vitit 2022: janar, shkurt, mars

Komuna e Rahovecit do të angazhohet që të rris standardin e shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe kualitetit të shërbimeve të ofruara;

DSHPS do të vazhdojë me respektim të masave dhe rekomandimeve të dala nga IKSHPK, dhe MSH, kundër pandemisë Covid-19.

Poashtu, DSHPS-ja do të përgatitet që të jetë e gatshme të përballojë fluksin e pacientëve në raste të gripave virusale, dhe në funksion të mbrojtjes nga pandemia COVID-19, njëashtu në dy QMF-të, në dy lokalitete të mëdha, si në: Krushë të Madhe dhe Ratkoc do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime mjekësore për qytetarët tanë me dy ndërtime.

Do të bëjmë përpjekjet e nevojshme për funksionalizimin e Repartit të Hemodializës në Rahovec, do të insistojmë të kemi veprime konkrete prej Spitalit Regjional në Prizren për rekrutim të stafit shëndetësor, pasi që hemodializa nuk hyn në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor është kompetencë e kujdesit dytësor.

Duke u bazuar në planin e prokurimit, do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale si dhe përcjellja e realizimit të projekteve që janë në vazhdim, me theks të veçantë projektet:

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Në tremujorin e dytë është mbështetja e familjeve në nevojë përmes projektit: “Furnizim me Material Ndërtimor për familjet në nevojë”.
- Inicimi i marrjes së vendimit për shërbime shëndetësore falas
- Bashkëpunim më i mirë me Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë
- Plan operacional për organizimin dhe veprimin e ekipeve lëvizëse shëndetësore në shërbim të qytetarëve
- Vizita mjekësore në shkolla.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Periudhën e tretë të vitit 2022 do ta karakterizojë furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë e subvencioneve për ndihma momentale.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokus i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioritet kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikmëri, si dhe planifikimi i buxhetit për vitin e ardhshëm.

Vizita e dytë shëndetësore nëpër shkollat e komunës së Rahovecit.

DREJTORIA PËR ARSIM

Në këtë plan janë të përfshira të gjitha aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Arsimit, për katër nivelet shkollore dhe atë si vijon:

- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),
- SNKA 2 - Arsimi i mesëm i ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 1 - Arsimi fillor (Klasat I-V),
- SNKA 0 - Klasat Parafillore/Përgatitore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje-5 vjeç).

Plani përfshinë aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASH-in, drejtoritë e tjera komunale, me qytetarët, komunitetin prindëror si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetin, etj. Plani ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendëve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin permanent të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie frytdhënëse;
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor, dhe
- Arritja e sukseseve më të mëdha të nxënësve të të gjitha niveleve.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2022 janë:

- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Funksionalizimi i plotë i çerdheve ekzistuese;
- Përfundimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike dhe teknologji informative.

Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2022 janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor;
- Nxitja e nxënësve për të mësuar përmes organizimit periodik të garave të diturisë në secilin nivel arsimor;
- Ngritja e cilësisë në arsim.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në tremujorin e parë, përveç që do të analizohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do të mbajmë aktive aktivet profesionale në secilën shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) të DKA-së.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Në tremujorin e dytë, Ekipi Profesional Vlerësues dhe Monitorues i DKA-së do të angazhohet në të gjitha shkollat dhe do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave, për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore dhe pakos pedagogjike po ecën mirë. Do të mbajmë gara të diturisë me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, do të bëhen përgatitje dhe do të organizohet testi i maturës për nxënësit e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9-ta. Do të zhvillojmë takimet e rregullta me drejtorët e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë vitit mësimor.

Angazhim konkret për iniciimin e planit për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Në tremujorin e tretë, do të bëhet planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2022/2023. Do të analizohen sukseset dhe mangësitë e vitit shkollor 2021/2022 dhe do të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023. Të

gjitha SHFMU-të do të furnizohen me tekste mësimore dhe do të marrim të gjitha masat e nevojshme që viti i ri shkollor të fillojë mbarë në të gjitha shkollat. Në këtë periudhë, do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin pasues 2023, dhe përmes kontratave të lidhura do të bëhet furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra, mjete konkretizimi, pajisje laboratorike dhe të teknologjisë informative. Do të bëhet furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo arsimore para muajit Nëntor dhe do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Në tremujorin e katërt, do të mbahen takime me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë vlerësuese të vitit të ri shkollor dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore. Gjithashtu, EPMV do të vizitojë të gjitha shkollat, me ç'rast do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave. Drejtori i DKA-së do të realizojë takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo shkollë.

Synime për vitin 2022:

Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkollë;

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Buxheti publik efikas

- Planifikimi i buxhetit hartohet nëpërmjet debateve me qytetarë;
- Projekte për thithjen e fondeve qeveritare –Investime kapitale;
- Zgjerimi i bazës së të hyrave vetanake.

Politikat e taksave dhe e të hyrave komunale

- Me programin zhvillimor politika e taksave komunale do të pësojë ndryshime pozitive në bashkëpunim me ligjet e financave publike, por edhe ndërmarrjes së hapave ambicioz dhe lehtësues për qytetarët;
- Politika gjithëpërfshirëse, reale dhe optimale;
- Zgjerimi i bazës dhe gjetja e burimeve të reja të taksave komunale;
- Tatimi në pronë, taksa urbanistike.

Politika buxhetore e të hyrave

- Të hyra për shërbimet komunale –shërbimet ndaj qytetarëve dhe
- Të hyra për përmirësimin e jetës së qytetarëve (investimet kapitale)

Rezultatet kryesore

Masat mbështetëse:

- Maksimizimi i të hyrave;
- Përmirësimi i kënaqshmërisë qytetare për të gjitha shërbimet.

- Ngritja e kompetencave për taksat lokale ;
- Ueb faqja dhe përfshirja e përmirësuar

Në bazë të detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga fushëveprimtaria e saj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa me Planin e Punës për Vitin 2022 parasheh realizimin e këtyre objektivave:

AKTIVITETET PËRSHKRIMI	PERIUDHA E KRYERJES	EKZEKUTUESI
Pasqyrat vjetore financiare 2021	Janar 2022	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Përgatitja e raportit financiar për kuvend 2021	Janar 2022	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Rrjedha e Parasë (Plani CASH)	Janar 2022	Drejtori i Drejtorisë dhe ZKF
Përgatitja dhe shpërndarja e faturave të tatimit në pronë	Shkurt 2022	Spektori i Tatimit në Pronë
Përgatitja për fillimin e implementimit të tatimit në tokë	Janar 2022	Spektori i Tatimit në Pronë
Regjistrimi dhe verifikimi i objekteve rezidenciale, biznesore, industriale etj	Permanente	Spektori i Tatimit në Pronë
Plan strategjia e realizimit të të hyrave komunale (tatimi në pronë, toka) në raport me planifikimin (I përfunduar)	Permanente	Spektori i Tatimit në Pronë
Planstrategjia e zgjerimit-rritjes të inkasimit hyrave nga: tatimi në tokë, legalizimi i objekteve, participimet nga bujqësia etj.	Permanente	Drejtori i drejtorisë në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë
Përgatitja e raportit tre mujor financiar 2022	Prill 2022	ZKF
Përgatitja e KAB-it komunal 2023-2026, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II	Qershor 2022	Drejtori i drejtorisë në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë
Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2021 në kuvend, i audituar nga ana e Zyrës së Auditimit Kombëtar	Qershor 2022	Drejtori i drejtorisë
Raporti Financiar 6 (gjashtë)mujor, janar-qershor 2022	Korrik -2022	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF

Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi dhe KPF	Qershor - Gusht 2022	Drejtori i drejtorisë
Dorëzimi i KAB-it komunal 2022- 2024, për votim në Kuvendin Komunal	Shtator 2022	Drejtori i drejtorisë
Futja e të dhënave në sistemin PIP dhe BDMS	Korrik- Shtator 2022	Zyrtarët e çertifikuar për sistem
Përgatitja e raportit nëntë mujor financiar 2022	Tetor 2022	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Mbyllja e vitit fiskal 2022 me një përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave komunale	Dhjetor 2022	Drejtori i drejtorisë

Synim kryesor i DPF-së për vitin 2022 do të jetë, zvogëlimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në fund të vitit 2022 si dhe mbyllja e vitit fiskal 2022, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit, dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, ka hartuar planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës sonë. Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2022 është hartuar me kujdes, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit gjatë tërë vitit dhe është i kategorizuar në periudha tre mujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në tremujorin e parë si dhe në tremujoret e tjerë të vitit 2022, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: lejet ndërtimore, lejet e rrënimit, kushtet ndërtimore, lejet mjedisore komunale, pëlqimet, vërtetimet urbanistike, njoftime dhe shkresa të ndryshme rreth zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe planeve të tjera rregulluese, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale, në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje, hartimi i planeve rregulluese urbane, sipas ligjeve të reja të planifikimit hapësinor do të vazhdojnë ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Zbatimin e Planit të Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit publik në afatin e përcaktuar në plan. Hartimin e projekteve në bazë të prioritetëve edhe për drejtoritë tjera dhe fillimin e punimeve për Sheshin Qendror të Qytetit, si projekti më i madh i vitit 2022.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, rritja e kualitetit të hartimit të projekteve të ndryshme për investime, përmes revidimit ose kontrollit dhe pranimi nga një komision profesional komunal, rritja e kualitetit të mbikëqyrjes, rrjedhimisht të punimeve në projektet kapitale, duke punuar ngushtë me organin mbikëqyrës, përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit, shënimi i ditëve ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit - janë disa nga planifikimet kyçe të DUPMM-së për këtë periudhë tremujore.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Aplikimi i masave të EE-së në projekte të ndryshme kapitale, trajtimi i objekteve me rëndësi të veçantë, rregullimi i varrezave të dëshmoreve, martirëve dhe civilëve, vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, përmes investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim mbrojtjen nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit, krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara, rregullimi i parqeve

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë: menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës, sigurisht, se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në kuadër të Komunës së Rahovecit ka një rol kyç në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së zhvillimit, siguron koordinim vertikal dhe horizontal dhe komunikim me të gjithë aktoret relevantë në proces, si brenda administratës komunale ashtu edhe me nivelin qendror, komunitetin dhe më gjerë.

Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm do të punojë sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale dhe do të ndërmarrë veprime të përcaktuara qartë dhe harmonizuara me objektivat strategjike të Strategjisë Zhvillimore Komunale si dhe dokumente tjera programore që kanë për qëllim ndikimin në përmirësimin dhe avansimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të ndërmarrë iniciativa të cilat qojnë në arritje të rezultateve konkrete dhe do t'i kushtohet vëmendje komunikimit konstruktiv me të gjitha institucionet relevante në nivel lokal dhe qendror, me donatorë, si dhe investitorë potencial të huaj dhe vendor. Po ashtu do t'i ofrohet mbështetje bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale. Një aktivitet kyç i kësaj drejtorie do të jetë inkurajimi i krijimit të bizneseve të reja duke ofruar shërbime bizneseve sidomos atyre fillestare në përgatitjen e aplikacioneve për thirrje për grante nga burimet e ndryshme financiare.

Një synim tjetër ku do të kemi çasje pro aktive do të jetë joshja e investitorëve vendor dhe të huaj përmes ofrimit të informatave profesionale relevante. Në anën tjetër do të identifikohen bizneset të cilat kanë interesim për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesor dhe për të hyrë në partneritet me investitorë potencial.

DZHE do të jetë e kyçur aktivisht edhe sa i përket implementimit të të gjitha projekteve të financuara nga ana e donatorëve të ndryshëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe maksimizimit të efektit të rezultateve të pritshme,

e në të njëjtën kohë do të angazhohet edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm potencial në rastet dhe projektet që mund të identifikohen në ndërkohë gjatë këtij mandati.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS

- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare për realizimin e projekteve zhvillimore;
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat;
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore e sidomos në projekte të investimeve kapitale;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal;
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale lidhur me përmirësimin e klimës për të bërë biznes;
- Komunikimin e vazhdueshëm me investitor potencial vendor dhe të huaj përfshirë diasporën me qëllim të informimit lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët;
- Promovimin e potencialeve turistike të komunës së Rahovecit në ndërlidhje me pakot e mundshme turistike në bashkëpunim me komunat e tjera të rajonit.

Prioritetet e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm:

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MIT-së për aplikim të fondeve dhe të granteve, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë periudhës tremujore janar, shkurt dhe mars, DEZHT planifikon ofrimin e mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese, duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale.

Planifikimi dhe regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2021 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2022, kalkulimi i ngarkesave për vitin 2022 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2022, mirëmbajtja e sistemit të pasurisë financiare dhe jo financiare, do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Regjistrimi i asetëve kapitale, mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira, si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale gjatë gjithë vitit, lidhja e kontratave të reja, rritja e inkasimit të të hyrave në taksa afariste komunale, ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e bizneseve do të vazhdojnë ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Hartimi i programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, si dhe përgatitja e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë - janë synim i yni, me fokus të veçantë, për vitin 2022.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Gjatë periudhës së tretë të vitit 2022, DEZHT planifikon të vazhdojë me shpërndarjen e të gjitha aktvendimeve të bizneseve për ngarkesën e taksave dhe të saldoeve ose (obligimeve të mbetura), si në taksa afariste komunale dhe në qira.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Në periudhën e katërt të vitit padyshim që prioritet i DEZHT-së mbetet realizimi i buxhetit në përpikmëri si dhe rritja e të hyrave komunale nëpërmjet inkasimit të të hyrave nga taksat dhe qiraja.

Prioritet i lartë:

Angazhim i vazhdueshëm bashkë me Qeverinë për të filluar investimet në zbatimin e projektit për aftësimin dhe aktivizimin e Zonës Ekonomike-Parku Industrial në Optrushë.

Plan komunal për krijimin e hapësirave të reja për biznese dhe investime private.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës ushtron veprimtarinë konform detyrimeve dhe përgjegjësisë që përcakton Statuti Komunal në realizimin e projekteve në disa rrafshë komplekse dhe shumëdimensionale, me theks të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, duke intervenuar optimalisht konform pozicioneve të përcaktuara sipas buxhetit komunal. Hartimi i planeve e projekteve konkrete afatshkurtra dhe afatmesme duke ju ofruar shërbime efektive dhe profesionale gjithnjë në të mirë të Komunës dhe qytetarëve të saj ka qenë dhe mbetet objektiv parësor.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente (Janar-Shkurt-Mars 2022);
- Heqjen e deponive ilegale të inerteve (Gjatë tërë vitit 2022);
- Analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, po ashtu, të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj. (Gjatë tërë vitit 2022);
- Hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, të rrugëve, ndriçimit publik, trotuareve, etj;
- Mbledhja e të hyrave nga sipërfaqet publike sipas rregullores së DSHP-së;
- Mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU-Gjakova si dhe investime të reja në ndërrim të gypave të ujit, zgjerime në ujësjellës dhe investime të reja në bashkëfinancim me komunën;

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioritetëve dhe planit të prokurimit (2022);
- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve;
- Ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioritetëve (Gjatë tërë vitit 2022);
- Vendosjen e disa pengesave në rrugë sipas standardeve të përcaktuara;
- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes;
- Krijimi i parkingjeve të reja në qytet;

- Kijimin e infrastrukturës së nevojshme për personat me nevoja të veçanta;
- Në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe kompaninë për autobartje të veturave, do të ketë angazhim gjatë gjithë vitit 2022;
- Ndriçimin publik në qytet dhe në të gjitha fshatrat e komunës sonë.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Vazhdimin e ndërtimit të rrugëve lokale qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës sonë;
- Fillimi i implementimit të planeve tjera për mbeturina, atyre të ngurta dhe ato të vëllimshme.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Trajtimin, largimin e qenve endacak në bazë të marrëveshjes së AVUK-it me kompanitë private të licencuara për trajtimin e tyre;
- Menaxhimi i deponive për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale- inerteve dhe rikultivimi dhe shndërrimi në hapësira gjelbruese;
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve;
- Përmbylljen e disa projekteve kapitale;
- Përgatitjen në fund-vit për mirëmbajtjen e rrugëve gjate sezonit dimëror;
- Raportin vjetor të drejtorisë, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të drejtorisë për vitin që vjen.

Synimet e DSHP-së

Përkushtim i veçantë i DSHP-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës publike për qytetarët e komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Infrastruktura publike në rrjetin e kanalizimeve fekale dhe gropave septike, zgjerimet;
- Ndërtimi i rrugëve lokale, ndriçimi publik, trotualet dhe mirëmbajtja e hapësirave publike.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia është sektor crucial për ekonominë e Rahovecit. Duke nisur nga kultivimi i rrushit, verës, perimeve, blegtorisë dhe bletarisë, bujqësia është sektori më i madh prodhues në komunë. Prandaj, orientimi kryesor duhet të jetë bujqësia, duke bërë investime të reja në modernizimin e punës në bujqësi, gjë që do të ndikonte edhe në rritjen e prodhimtarisë dhe kualitetit.

Duke pasur parasysh se sektori i Bujqësisë është në fokusin kryesor të Komunës sonë, Drejtoria për BPZHR, për vitin 2022 ka paraparë që të vazhdojë mbështetjen e fermerëve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit. DBPZHR këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Zbatimin të politikave zhvillimore përmes përkrahjes direkte të fermerëve – subvencionimit;
- Shërbimeve këshillimore, si një instrument shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen e vetëdijes dhe avansimit të ofritit të produktve sa më cilësore;
- Implementimit të projekteve kapitale në bujqësi që ndikon në mbrojtje të produkteve bujqësore;
- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2022, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranime teknike të projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie, si dhe në komisione të tjera sipas nevojave dhe kërkesave që do të parashtrihen në drejtorinë tonë.

Prioritetet e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MBPZHR-së për skemën e pagesave direkte dhe të grandeve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Këtë periudhë tremujore do ta karakterizojë kryesisht trajtimi i aplikacioneve për skemën e grandeve dhe pagesave direkte duke u bazuar në thirrjet për aplikime që do të hapen nga MBPZHR. Stafi i drejtorisë synojmë të jetë i gatshëm të përballojë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit të gjitha dosjet do të dorëzohen në Agjencionin për zhvillimin e bujqësisë për të vazhduar me kontrollën administrative dhe kontrollën e terrenit në mënyrë që të hapet rruga për pagesa të vitit 2022.

Përcjellja e projekteve kapitale, si: rregullimi i rrugëve fushore, ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe dranazhimit të tokave bujqësore, përkrahje e fermerëve me serra, stalla, ferma të vogla, inpute dhe pajisje bujqësore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Periudha kyçe në këtë vit është kjo në të cilën pritet të hapen thirrjet nga komuna për përkrahje të fermerëve me grande. Në këtë periudhë do të hapen thirrje për të përkrahur fermerët në të gjithë sektorët me mekanizëm bujqësor, si: sektori i vreshtarisë, sektori i perimekulturës, blegtorisë, bletarisë etj.

Përcjellja e mbjelljeve pranverore për të parë më afër ecurinë e punëve agroteknike, duke iu ofruar këshillat e nevojshme fermerëve për mbjellje, në mënyrë që të kenë rendiment dhe cilësi të kënaqshme.

Formimi i komisioneve për përzgjedhjen e përfituesve të hapur nga thirrja e BPZHR dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale do të vazhdojnë ta përcjellin këtë periudhë tremujore.

Përmes thirrjeve publike që do të hapen do të jenë të përfshirë pothuajse të gjithë sektorët e bujqësisë që zhvillohen në komunën tonë.

Padyshim që theksi do të bie në sektorin e vreshtarisë, perime-kulturës, blegtorisë dhe lavërtarisë por, nuk do të mbesin anash edhe sektorët tjetër siç janë; bimët mjekësore e aromatike, ato të përpunimit të pemëve dhe perimeve duke avansuar edhe në sektorin e prodhimit të produkteve jo alkoolike si: Pekmez, Reqel, Pestil etj.

Periudha kohore nga janari deri në qershor kryesisht do t'i ketë tri objektiva:

- Përfundimi me sukses i fazës së aplikimit për subvencione në kuadër të MBPZHR-së
- Inicimi i procedurave për shpallje të tenderëve për investime kapitale nga buxheti i ndarë për drejtorinë e bujqësisë, dhe
- Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë për fermerët përfitues.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Korrje-shirjet do ta karakterizojnë periudhën e tretë të vitit. Poashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë dhe pa anime e grandeve të vogla nga komuna e Rahovecit.

Tradita e vjeljes së rrushit sikur vitet paraprake edhe gjatë vitit 2022, do të organizohet gjatë muajit shtator, ku komuna e Rahovecit do të ofrojë mbështetje OJQ-ve rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së festave me karakter bujqësor si: HardhFest, Agrofesta, Panairi i Produkteve në fund të vitit etj.

Kjo periudhë kohore do të karakterizohet edhe me funksionalizimn e plotë të tregut të rrushit ku tani e sa vite jemi duke investuar dhe përgatitur për fermerët e komunës sonë me qëllimin e vetëm që të kenë mundësi dhe qasje që produktet e tyre t'i plasojnë te konsumatori përmes këtij tregu.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Periudha e fundit të vitit do të karakterizohet me përcjelljen e mbledhjeve të prodhimeve vjeshtore, koordinimi i bodrumeve për grumbullim të rrushit si dhe përpunueseve të perimeve në tërë territorin e komunës sonë.

Kjo periudhë kohore do të karakterizohet me formim të komisioneve për verifikim të afërmëve që janë përfitues nga fondet e komunës se Rahovecit gjatë viteve 2021-2022.

Sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri.

Periudha kohore nga korriku deri ne dhjetor kryesisht do ti ketë tre objektiva:

- Fushata e korrje shirjeve;
- Përcjellja e investimeve kapitale dhe shpenzimi i buxhetit në përpikmëri;
- Komisionet e verifikimit të përfituesve për mekanizëm bujqësor;
- Organizimi i festave që kanë karakter promovimin e produkteve bujqësore të komunës sonë.

Synimet e DBPZHR-së

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vjeshëm të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrenjve, si dhe

Sektori i pylltarisë

Në kuadër të sektorit të pylltarisë fokusi do të jetë:

- Mbrojtja e pyjeve;
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja;
- Bashkëpunim i qëndrueshëm me Agjencinë Pyjore të Kosovës për pronat që janë dhënë në shfrytëzim;
- Angazhim maksimal në parandalimin e zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sektori i zhvillimit rural

Edhe zhvillimit rural do t'i jepet rëndësi e veçantë duke u nisur nga fakti se komuna jonë njihet si një zonë me zhvillim të theksuar rural.

Me kujdes të veçantë do te trajtohen aspektet për trajtim dhe mbrojtje të faunës e cila është mjaft e pasur, falë rrjedhave të shumta të ujërave në tërë territorin e komunës sonë.

Gjuetia dhe peshkataria do të jenë dy fusha që do të kenë vëmendje të shtuar në planet tona.

Synimi ynë:

- Përgatitja e një plani të qartë për përkrahjen e fermerëve si: ndërtimi me partneritet i qendrës për magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve dhe dhomat ftohëse e forma të tjera të përkrahjes së fermerëve.
- Angazhim për të marrë përkrahje nga Kuvendi i Kosovës kërkesa jonë e kahmotshme që Rahoveci të ketë Ligj të Veçantë për Bujqësi.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Fillimi i vitit të ri, do të fillojë me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2022 do t'i qasemi punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

Prioritetet e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Prioritetet tona kryesore gjatë vitit 2022 do të fokusohen në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht. Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime komfor akteve juridike.

- Vazhdimi i evidentimit dhe lirit të pronave të uzurpuara në nivel të komunës;
- Gjeoreferencimi i hartave- planeve gjeodezike të pa përfunduara;
- Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të pa skanuar;
- Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike në nivel të Komunës.

Sfidat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

- Themelimi i komisionit për komosacion;
- Vazhdimi i migrimit të zonave kadastrale në komosacion të zonave që nuk janë të migruara në nivel të komunës;
- Rindërtimi i zonave kadastrale në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

SEKTORI PËR KADASTËR DHE PRONË

- Sektori për Kadastër dhe Pronë, gjatë periudhës një vjecare parashihet që të pranojë dhe kryej më shumë se 1400 lëndë.

SEKTORI PËR GJEODEZI

- Sektori për Gjeodezi parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 650 lëndë.
- Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2021 pritet që të ketë rritje të kërkesave për nxjerrjen e certifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritët t'ju ndajë Qeveria e Kosovës,

këtë proces do ta menaxhojmë me shumë kujdes duke e rritur stafin mbështetës dhe do të jemi në shërbim të qytetarëve me shumë profesionalizëm dhe në kohë reale.

- Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta kenë në terren, si dhe shërbimi pronësoreshë juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevojat e Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.
- Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë vendërsitë e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë, kjo mbetet sfidë që të përfundohen deri në fillim të vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekem:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal;
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekte të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik;
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera;
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare;
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare;
- Punë të tjera sipas planit;
- Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.

Detyrat e tjera të Drejtorisë

- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodetëve Komunal jashtë drejtorisë;
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve në nivel të Komunës;
- Dalja në terren e Shërbimit pronësoreshë-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion;
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel Komune.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për gjatë vitit 2022, planifikon të organizojë aktivitete në fusha me rëndësi për jetën e përditshme, duke përfshirë ato muzikore, shfaqje teatrale, art, aktivitete rinore, sportive dhe hartim të projekteve për ruajtjen e trashëgimisë historike e kulturore.

Përveç buxhetit komunal, prioritet është gjetja e burimeve tjera financiare, duke përfshirë edhe ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar, si dhe thellimin e bashkëpunimit me komunat tjera, OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm.

Prioritetet për vitin 2022:

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- Shtëpia e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc;
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Hoçë të Madhe;
- Stadiumi "Jahja Danuza" & fushat sportive dhe rekreative;

- Palestra "Mizahir Isma".

Gjatë muajve të parë të vitit 2022, DKRS do përkushtohet maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës.

- Përkrahja dhe nxitja (frymëzimi) i krijuesve dhe kreativitetit kulturor;
- Zbatimi i planit të prokurimit për projekte kapitale;
- Hartimi i projekteve në kuadër të projekteve kapitale.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Prioritetet dhe puna në kuadër të tri sektorëve, për periudhën e tre mujorit të parë:

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Mbështetja e eventeve gjithpërfshirëse lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare: festivale, panairë artizanati etj;
- Ndarja e subvencioneve në dy periudha, në kuadër të sektorit të Kulturës dhe Rinisë dhe Sportit;
- Nxitja e bashkëpunimit me OJQ-të në nivel komunal e më gjerë, përmes takimeve të ndryshme;
- Organizime dhe përgatitje rreth Manifestimit kulturor dhe përkujtimor "Flaka e Janarit"
- Shpallja e konkursit letrar për fëmijë dhe të rinj;
- Organizime dhe përgatitje rreth festës së Pavarësisë -17 Shkurti;
- Epopeja e UÇK-së;
- Tryezë diskutimi me të burgosur politik, për Ditën Ndërkombëtare e të burgosurve politik;
- Forcimin e rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për masovizim të sportit, përmes shënimit të datave me rëndësi për sportin, dhe organizimeve të ndryshme rreth sensibilizimit;
- Vazhdimi i aktiviteteve në kuadër të këndit librar;
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, me aktivitete të ndryshme;
- Ndërtimi i terreneve sportive dhe rekreative, dhe mirëmbajtja e këtyre hapësirave;

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Gjallërimi i jetës kulturore- artistike si edhe nxitja, promovimi i talentëve të reja dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme;
- Organizimin e trajnimeve që kanë qëllim vetëdijësimin e të rinjëve;
- Pjesëmarrja e punonjësve të bibliotekave, në trajnime/ konferenca lidhur me librin, në nivel regional dhe qendror;
- Përgatitja e specifikacionit "Furnizime me flamuj, kurora e buqeta lulesh";
- Organizim të aktiviteteve, për nder të Ditës së Monumenteve Kulturore e Historike;
- Organizimi i garave sportive e kulturore, në kuadër të festave zyrtare;
- Art n'Vneshta të Rahovecit;
- Rahoveci Tour – 2022;
- Manifestimet kulturore e përkujtimore "Java e Dëshmorëve";
- Festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" (21 vjetori);
- Dita e Qendrës së Shtëpisë së Kulturës "Mensur Zymberaj";
- Aktivitet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve;
- Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit;
- Festivali Mbarëkombëtar i Muzikës Klasike "Do Re Mi- Unë dhe Ti";

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Organizimi i aktiviteteve edukativo-arsimore në bibliotekë;
- Evidentimi i punës në bibliotekë, përmes kartelave të librit;
- Përgatitja e informatave, lidhur me ecurinë e lexuesve në bibliotekë;
- Furnizimi me libra në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" dhe nëndegë;
- Organizime rreth përgatitjeve për festivalin, Hardh Fest 2022;
- Organizime në kuadër të Muajit të mërgatës;
- Organizim të aktiviteteve sportive, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe;
- Përfshirja e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara në aktivitete;
- Organizim të aktiviteteve sportive, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë;
- Organizimi i ekspozitave në bashkëpunim me OJQ- të;
- Organizimi i shfaqjeve teatrale;
- Ekspozitë me fotografi, nga fotografët e komunës së Rahovecit;
- Organizim të trajnimeve për ndërmarrësi, për të rinjtë.

Tremujori i katërt: tetor, nëtor, dhjetor

- Në kuadër të bibliotekave, do të përgatiten raportet, përpunimi fizik i materialeve bibliotekare, regjistrimi i anëtarësimeve të reja, promovimi i aktiviteteve në faqen e bibliotekës, fuqizimi i librit përmes vizitave në shkolla dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme;
- Përkrahja dhe frymëzim i krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor, përmes shpalljes së konkursave letrare gjatë festave zyrtare dhe subvencioneve;
- Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi";
- Shpallja e konkursit për Çmimin "Sulejman Krasniqi"
- Aktivitete përkujtimore e kulturore për "Festat e Nëntorit";
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale që të përfshihen në sa më shumë në aktivitete;
- Promovimi i sportit në mesin e të rinjëve, si dhe identifikimi dhe përkrahja e talentëve të rinjë;
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe;
- Formimi i Keshillit Organizativ, për Sportistin e Vitit "2021"
- Organizim të aktiviteteve në kuadër të "Javës Olimpikë";
- Organizimi i aktivitetit Kros Vjeshtor;
- Dita Botërore e Librit;
- Dita e 28 Nëntorit, festa e Flamurit Kombëtar;
- Dita Kombëtare e Rinisë;
- Përmirësimi, ndërtimi i terreneve sportive dhe mirëmbajtja e këtyre objekteve.

Përveç këtyre punëve, do realizohen edhe aktivitete e punë të përditshme, si:

- Raportet javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Takimi me klube dhe shoqata sportive;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore e sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve sportive;
- Takime me rini.

Prioritet i lartë:

Insistim i vazhdueshëm në MKRS që ajo të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për fillimin e punimeve në tri projektet që i ka marrë përsipër t'i realizojë në komunën e Rahovecit (shih memorandumet e bashkëpunimit me MKRS-në), si:

- Ndërtimi i stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-së;
- Ndërtimin i palestrës sportive në Krushë të Madhe;
- Ndërtimin i stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc.
- Komuna do të angazhohet të gjejë përkrahje për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e Qendrës për Art, Kulturë dhe Inovacion.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2022, sipas dinamikës së punëve do të zbatohet të gjitha ligjet përkatëse, sipas specifikave të lëmive të inspektorëve: tregtisë, sanitarisë, veterinarisë, ndërtimtarisë, pronësisë, komunikacionit dhe të mjedisit.

DPI këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet gjegjëse si:

- Policinë e Kosovës, Stacionin Policor Rahovec
- Gjykatën Themelore në Gjakovë- dega Rahovec
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile
- Koordinimi i veprimeve me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Inspektorët Rajonal
- Bashkëpunimi me operatorët e transportit publik dhe të mallrave

Plani për drejtorinë inspektuese ka këto qëllime kryesore:

Mbrojtja sa më efikase e interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komuniteti i biznesit, qytetarët etj.

Synimet kryesore

Zbatimi i plotë dhe i pa anshëm i rregullatave ligjore dhe nënligjore që është në fuqi, identifikimi dhe eliminimi i dukurive negative.

Objektivat

- Menaxhimi, parandalimi dhe luftimi i pandemisë Covid-19;
- Dyfishimi i përpjekjeve për mbrojtje të ambientit;
- Eliminimi i ideponive ilegale;
- Ndalimin e ekspozimit të produkteve ushqimore sipas rregullores në fuqi;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore;
- Mbrojtjen e pronës publike;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje
- Luftimi i ekonomisë informale.

Prioritetet e Drejtorisë për Punë Inspektuese:

Duke u bazuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, planifikojmë të bëjmë kompletimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak, duke respektuar afatet procedurale e ligjore.

Në këtë fazë kryesisht fillojnë përgatitjet për ndërtime pranverore, por si ngecje do të jenë kushtet atmosferike dhe ne do të jemi vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve do të verifikojmë objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi, do të merren masa paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi.

Ndalimi dhe asgjësimi i mallrave që shkaktojnë dëme dhe rrezik për shëndetin, jetën dhe mjedisin e konsumatorëve, kontrole të vazhdueshme në transportim dhe bartje të mallit, gjë kjo e cila mund të arrihet përmes bashkëpunimit të inspektorit të tregut në koordinim me inspektorët e tjerë dhe organet e autorizuar.

Kontrollimi i objekteve shkollore dhe parashkollore, shëndetësore, kulturës fizike, sportit dhe rekreacionit, objektet e mbajtjes së higjienës personale, objektet publike, objekteve për furnizim me ujë të pijshëm etj.

Detyrimi i biznesve për legalizimin e veprimtarisë pranë zyrës së bizneseve në Rahovec.

Kontrollimi i mishtoreve dhe thertoreve gjatë tërë vitit, inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet jo ligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinarë dhe bujqësore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, do të merremi me lëndët e plotëfuqishme me qëllim që t'i ekzekutojmë këto lëndë, duke u përqendruar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, aty ku janë evidentuar uzurpues të pronave publike.

Bashkëpunimi me inspektorët e nivelit qendror për mjedis lidhur me koordinimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit, të mbikëqyrjes së hapësirave të gjelbëruara, të inspektimit të ambulantave dhe barnatoreve shëndetësore lidhur me menaxhimin e mbeturinave sanitare, aktivitete këto që do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Kontrollime mbi cilësitë, çmimet dhe kushtet e shitjes me çmime në aksion në të gjitha lokalitetet.

Kontrollimi i objekteve hoteliere, kushtet higjienike-sanitare, ushqimi, personeli, hapësirat e punës, menaxhimi i mbeturinave etj.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, synim kryesor kemi inspektimin dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve të vjetra nga aspekti i mirëmbajtjes, mbrojtjen e konsumatorëve, luftimin e tregtisë joformale dhe konkurrencës së padrejtë tregtare si dhe mbikëqyrjen e kushteve higjienike sanitare nëpër të gjitha objektet publike.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Këtë periudhë tremujore e karakterizon fluks më i shtuar i numrit të automjeteve nga mërgimtarët tanë, si dhe sezona e pushimeve verore, andaj, inspektori i komunikacionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor në Rahovec, Njësinë e Trafikut, do të kujdesen për krijimin e sigurtisë më të madhe dhe qarkullimin e lirë në komunikacion.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave tona kemi paraparë edhe planifikimin rreth furnizimit me shenja horizontale dhe vertikale të komunikacionit, për rrugët e reja dhe mirëmbajtjen e shenjave në rrugët ekzistuese.

Mbikëqyrja e kyçjeve në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga personat fizik dhe juridik, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, ujitja e kopshteve etj), mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore (ekzekutimi i punëve publike apo private), mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, do të vazhdojnë ta karakterizojnë periudhën tremujore.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë verifikimi i të gjitha dokumenteve si: procesverbale, vendime, njoftime etj.

Sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, rritja e presionit në mënyrë të vazhdueshme në gjykata me qëllim shqyrtimin e lëndëve të dërguara nga inspektoriat, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, pranim-shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022, synim kryesor kemi mbrojtjen sa më efikase të interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komunitetin e biznesit dhe qytetarët, si dhe zbatimin e plotë dhe të paanshëm të rregullativës ligjore dhe nënligjore që është në fuqi, identifikimin dhe eliminimin e dukurive negative, vendosja konform ligjeve për mbishkrime, panot dhe tabelat reklamuese, kontrolli rreth shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) në punën e saj mbështetet: në ligjet, urdhëresat administrative dhe rregulloret në fuqi. Aktivitetet e drejtorisë janë të vazhdueshme dhe të pa parashikuara sipas intensitetit që mund të ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera brenda vitit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) për vitin 2022 planifikon të bëjë këto aktivitete:

Emërtimi i detyrave/aktiviteteve të planifikuara	Bartësi i detyrës/aktiviteteve	Bashkëpunimi me:	Periudha e realizimit:
Inspektimi i lumenjve, përroskave dhe kanaleve të hapura.	Zyrtari për Emergjencë	D.SH.P.K	Janar- Mars
Plani i Reagimit Emergjent	Spektori i Emergjencës	Zyr.Emergjencës Ins.Parandalimit	Janar- Mars
Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.	DMSH		Janar-Dhjetor
Ndërmarrja e masave të menjëhershme në ofrimin e ndihmës me rastin e shfaqjes së fatkeqësive elementare dhe aksidenteve.	DMSH	NJPZSH, PK-ës, FSK, Shërbimet Emergjente.	Janar-Dhjetor

Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit elementare dhe ndërmarja e masave adekuatë për sanimin e gjendjes	DMSH	Në bashkëpunim me Drejtorit tjerë përkatës.	Janar- Dhjetor
Servisimi i Aparatave kundër zjarrit.	DMSH	D. Administratës D. Shëndetësisë D. Arsimit D. Kulturës	Janar- Dhjetor
Angazhimi në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.	Drejtori i DMSH	Kryetarin e Komunës, KKS	Janar-Dhjetor
Verifikimi i përgatitjeve për intervenim të forcave dhe të mjeteve për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë.	DMSH	Zyrt.Emergjencës	Prill- Qershor
Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijimin e qytetarëve- nxënësve të shkollave nga lamia e mbrojtjes nga zjarri.	DMSH	Ins.Parandalimit Zyr.Emergjencës	Korrik-Shtator
Bashkëpunim me sektor, shërbime e zyre të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikim dhe veprim në raste emergjente.	Zyrtari për Emergjencë	Drejtoria për Bujqësi Policia e Kosovës dhe Shërbimi Emergjent.	Korrik-Shtator
Regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste Emergjente.	Zyrtari për Emergjencë	NJPZSH	Prill-Qershor
Ngritja e nivelit të gatishmëris emergjente në Komunë.	DMSH	Drejtoritë dhe Institucionet tjera të Komunës.	Korrik-Shtator
Përpilimi i raporterve dhe informatave të ndryshme nga lëmia e mbrojtjes dhe shpëtimit	DMSH		Janar- Dhjetor
Planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materjalo-teknike për nevojat emergjente.	DMSH	Institucionet, kompanit publike dhe private.	Janar- Dhjetor
Përcjellja e gjendjes së gatishmëris dhe organizimi në hapsirën e mbrojtjes dhe shpëtimit.	Zyrtari për Emergjencë	Drejtori i DMSH	Korrik-Shtator
Inspektimi i rregullt i objekteve publike.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Inspektimi i rregullt i objekteve ekonomike dhe private.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Inspektimet Verifikuese, kontrolli i eliminimit të mangësive.	Ins.Parandalimit	DMSH	Janar-Dhjetor
Kontroilli i radio-lidhjeve -Azhurimi i frekuencave	DMSH	QRAKE-Prizren	Sipas planit të QRAKE
Koordinimi i punëve rreth dhënies së pëlqimeve në dokumentacion investivo-teknik dhe në lokacion, respektimi i standardeve për raste emergjente.	Ins.Parandalimit	AME/MPB	Janar-Dhjetor
Planifikimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të DMSH, në trajnime	DMSH	MPB/AME	Janar- Mars

PËRFUNDIM

Përkundër të gjitha sfidave, plani i qeverisjes së Rahovecit, do t'i jep identitet të veçantë qeverisjes lokale në Rahovec.

Ky plan është punuar me pjesëmarrjen e të gjithë drejtorëve të drejtorive përkatëse, poashtu, edhe të udhëheqësve të njësive në kuadër të zyrës së Kryetarit të komunës së Rahovecit.

Në planin vjetor të punës për vitin 2022 reflektohen plotësisht nevojat e qytetarëve të komunës së Rahovecit të identifikuar nga shumë takime që janë bërë në të gjitha lokalitetet e komunës. Si i tillë, ky plan është real, përmbajtësor dhe bazohet në gjendjen aktuale dhe objektivat zhvillimore të komunës, e zbatimi i tij kërkon energji të madhe, vullnet veprues dhe dinamikë të lartë pune.

Projektet apo investimet kapitale me vlerë strategjike janë shtylla kryesore e krijimit dhe forcimit të identitetit qeverisës së Rahovecit.

Me fjalë të tjera, këto projekte i japin Rahovecit vulën e mirëqeverisjes lokale në Kosovë dhe e bëjnë shembull i një komune të zhvilluar, e që përmes qeverisjes efektive qytetarët sjellë identitetin e veçantë të një komune të fortë, inovative e përparimtare.

Si kryetar komune bashkë me ekipin tim jemi të përkushtuar për të kryer shërbime ku qytetarët janë në rend të parë, trajtim me mirësjellje dhe respekt ndaj tyre, duke e këshilluar dhe ndihmuar atë në zgjidhjen e problemeve, duke besuar se këto vazhdojnë të mbeten vlerat e qeverisjes sonë e që reflektohen edhe në Planin Vjetor të Punës për vitin 2022.

Jemi krenarë për profesionalizmin, kompetencën dhe dedikimin që ekziston në ekipin tonë qeverisës. Ne njohim dhe vlerësojmë veçantinë e çdo individi, si dhe vlerësojmë kontributin e dhënë dhe sinergjinë e krijuar nga përvoja dhe perspektiva të ndryshme.

Jemi të përkushtuar për të trajtuar çdo qytetarë me respekt dhe dinjitet.

Vazhdojmë me punë....

Vërejtje: Plani mund të pasurohet me ide, propozime e këshillat e juaja, sikundër që mund të jepen edhe vërejtje, në mënyrë që ta bëjmë edhe më të mirë.

Ju faleminderit!

Smajl Latifi, Kryetari i Komunës së Rahovecit